

UNITED NATIONS
United Nations Interim
Administration Mission
in Kosovo



NATIONS UNIES
Mission d'Administration Intérimaire
des Nations Unies au Kosovo

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

**KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO**

TRANSKRIPT

NGA SEANCA PLENARE E KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR MË

14 NËNTOR 2002

TRANSKRIPT

SA PLENARNE SEDNICE SKUPŠTINE KOSOVA, ODRŽANE

14. NOVEMBRA 2002.

NËNTOR – NOVEMBAR

2002

PROVISIONAL INSTITUTIONS OF SELF GOVERNMENT

KUVENDI I KOSOVËS
СКУПШТИНА КОСОВА
ASSEMBLY OF KOSOVO

RENDI I DITËS

Propozimi i rendit të ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës
2. Procesverbali nga mbledhja e kaluar
- 3.1 Vazhdimi i punës nga 7 nëntori 2002 (të konfirmohet)
Në kuadër të kësaj mund të përfshihet
Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për aktivitetet e tregtisë me jashtë dhe
Rekomandimet e Këshillit gjyqësor dhe i prokurorëve për emrin e
gjyqëtarve dhe prokurorëve
- 3.2 Shqyrtimi i parë i Projektligjit për pylltari të Kosovës (2002/10)
4. Parashtrimi i pyetjeve

Vrejtje : *Pyetjet për Qeverinë për përgjigjet me gojë*

“Pjetjet për përgjigjet me gojë duhet ti dorzohen Zyrës për parashresa të paktën pesë ditë pune
por jo më shumë se dhjetë ditë pune para kohës kur duhet përgjigjur në to “.
(Rregulla 19.2 nga Rregullorja e përkohshme e punës)

ДНЕВНИ РЕД

Предлог дневног реда:

1. Усвајање дневног реда
2. Записник од претходне седнице
- 3.1 Наставак рада са 7 новембра 2002 год. (потврдити)
У оквиру овога може се уврстити
Друго разматрање Нацрта закона о активностима спољне трговине и
Препоруке судског веча и тужиластва за именовање судија и тужиоца

TRANSKRIPT

NGA MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË KOSOVËS, E MBAJTUR

14 NËNTOR 2002

Mbledhja filloi punën në orën 10,15.

Mbledhjen e kryesoi z. Nexhat Daci, kryetar i Kuendit të Kosovës

KRYESUESI NEXHAT DACI:

Mirëmëngjes dhe mirë se keni ardhur në Seancën e rregullt plenare, kolegë deputetë.

Shpresoj se materialet e duhura ju janë shpërndarë me kohë dhe se mund të procedojmë sipas rendit të ditës.

Para se t'ju pyes lidhur me rendin e ditës, duhet të ju informoj se nga Qeveria ka ardhur një shkresë në mes të së cilës Ministri i agrokulturës kërkon ndjesë që nuk do të jetë prezent në këtë seancë plenare dhe se në seancën e ardhme do t'u paraqesë të dhënat hyrëse për Ligjin që e ka propozuar për Parlament. Prandaj, duhet të heqet leximi i parë i Draftligjit për pyjet në Kosovë, siç është definuar.

Unë shpresoj se mund të procedojmë dhe mendoj se e pranon rendin e ditës me këtë ndryshim. Nëse ka ndokush, urdhëroni. E ka fjalën z. Haki Shatri.

HAKI SHATRI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,

Lidhur me rendin e ditës, unë desha ta paraqes situatën si është te Komisioni për Buxhet, domethënë rrëth pikës për vazhdimin e diskutimit ose shqyrtimit të dytë të Projektligjit për aktivitetin e tregtisë me jashtë. Kam obligim para anëtarëve të Komisionit që Kuvendit t'ia sqaroj se asnjëherë Ligji për tregtinë me jashtë nuk është shtyrë për shkak të punës dhe aktivitetit të Komisionit për Buxhet. Ne me kohë i kemi kryer punët deri tash. Mirëpo, ajo që morëm dje në postën zyrtare të deputetëve janë shkresat të cilat tregojnë se Komisioni nuk ka mundur me i diskutue, as syqjerimet e këshilltarit juridik të UNMIK-ut, as shkresën me të cilën Qeveria i drejtohet Kuvendit e me të cilën i njofton deputetët se një pjesë të syqjerimeve të këshilltarit juridik i pranon kurse pjesën tjetër nuk e pranon. Por, Komisioni ynë për Buxhet, pra, nuk ka pasur kurrfarë mundësie t'i shqyrtojë para kësaj seance. Prandaj, propozimi im është që t'i jipet mundësi Komisionit t'i shqyrtojë. Unë droj se gjatë kësaj seance, do të

thotë në pauzë eventuale, është vështirë t'i jipet përgjegja, sepse vëllimi i vërejtjeve dhe të atyre që janë pranuar nga ana e Qeverisë në këtë projektlig është vëllim mjaft i madh, rreth 29 nene apo amendamente janë propozuar që të ndryshohen dhe të pajtohet me të Qeveria, prandaj gjatë ditës së sotme është vështirë dhe po e lëmë këtë të hapur e le të vendosë Kuvendi a të bëhet kjo sot apo të shtyhet për ndonjëherë tjeter. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Zoti Shatri të falemnderit. E ka fjalën Bajrush Xhemajli.

BAJRUSH XHEMAJLI:

Kryesi e nderuar, të nderuar ministra, të nderuar deputetë,
Unë, kur është shtyrë për herë të parë ky ligj për tregti të jashtme, kam reaguar se ne komisionet e kemi kryer punën dhe është mirë të dihet se kush nuk e ka kryer.
Kryetari është përgjigjur: – ndonjë komision. Ka mund të jetë edhe ashtu, por ai komision ka qenë për minoritete, po mendoj për komunitete. Dhe, pse nuk është takuar ai komision, mendoj se ka treguar rrjedha e pastajme lidhur me trajtimin e këtij ligji. Doli se shkak për këtë kanë qenë komentet e UNMIK-ut që i ka dhënë më 30 titor dhe ndaj këtyre komenteve pastaj është përgjigjur zyra e Kryeministrat dhe nuk është fjala për një a dy komente por për 29 komente, që do të thotë është një volum i madh i trajtimit, vërtetë shkaku i kontestimit në fakt i këtij ligji nga UNMIK-u është se deri dje nuk ka pasur as përkthim të këtij materiali. Dje është përkthyer. Do të thotë, shifet qartë se zhagjtja ka qenë për shkak të punëve apo më mirë të them të mospunës së UNMIK-ut. Unë mendoj se së pari ky ligj duhet të shqyrtohet dhe t'i kalojë të gjitha procedurat për të dalë para Kuvendit dhe kur të dilet para Kuvendit, mendoj se atëherë e kanë fjalën kuvendarët. Por, tash po del se nuk është krejt kështu. Unë, si kryetar Komisioni, mendoj se nuk ka dashur të vijë deri këtu, por nëse është dashur të komentohen këto, të komentohen menjëherë dhe të kryhet puna shpejt e të mos zhagitet një muaj ditë Ligji pa kurrfarë nevoje dhe të dalim tash në pikën zero, në pikën e fillimit. Në fakt tash jemi sikur kur është dalë Projektligji këtu para nesh për herë të parë. Mendoj se s'kam edhe kompetencë të jap ndonjë mendim në emër të Komisoinit dhe prej dje ne s'kemi pasur edhe mundësi të takohemi dhe kjo mbetet, deshëm apo s'deshëm, për më vonë. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Urdhëroni.

SADUDIN BERISHA:

I nderuari kryetar,
U përmend se komisionet nuk e kanë bërë punën e vet rreth shqyrimit të amendamenteve të Projektligjit mbi aktivitetin me tregtinë e jashtme. Unë them se Komisioni për punë me komunitete, punën e ka bërë me kohë me 6 të këtij muaji dhe

nuk qëndron fajsia e këtij Komisioni. Është një e vërtetë se dy komisionerë kryesore që janë në Kuendin e Kosovës do të duhej t'i kenë takimet e fundit rrëth dhëni së vlerësimeve për projektligje të caktuara, kështu që të mos ndodhë që pas seancave të këtyre komisioneve të vijnë plotësimë dhe ndryshime të ndryshme nga të tjerët. Këtu kemi edhe rekomandimet nga Komisioni. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Edhe në Kryesinë e fundit, gjatë është debatuar për këtë çështje dhe adresimi ka qenë i qartë. Një numër i komenteve dhe i vërejtjeve kanë ardhur nga zyra ligjore e Përfaqësuesit special. Të gjitha ato vërejtje apo komente janë bërë në një gjuhë, nga një zyrë e cila, gjithmonë, insiston që të rrespektohen rregulloret. Ato komente deri në fund të javës kanë qenë vetëm në anglishtë dhe ne, në seancën e Kryesisë, kemi vendosur se: – në qoftë se gjatë të martës, të mërkurës nuk vijnë të përkthyera, ato komente do të konsiderohen si inekzistente. Prandaj, ato kanë ardhur, kanë arritur të përkthyera. Komisionet i kanë kryer punët e veta por nuk e kanë pasur shancin që të japid mendimin edhe për ato amendamente, apo ato vërejtje të zyrës ligjore që janë bërë.

Meqë jemi në një fazë të zhvillimeve shumë dinamike dhe unë e falënderoj edhe ministrin që është i pranishëm, në një mënyrë do të thotë jemi të obliguar ta respektojmë procedurën që çdo amendament ose çdo mendim që vjen me kohë të futet në procedurën e shqyrtimit dhe edhe kjo pikë e rendit të ditës prapë nuk do të mund të shqyrtohet, do të thotë as shqyrtimi përfundimtar apo i dytë i Ligjit mbi tregtinë e jashtme nuk mund të jetë në rend dite. Unë kërkoj mirëkuptim nga deputetët sepse, edhe po të humbim kushedi sa orë debate për këtë, nuk mund të jetë në rend dite. Ju falemnderit. Urdhëroni zoti Kurteshi.

ISMAJL KURTESHI:

E nderuara Kryesi, deputetë dhe ministra të nderuar,
Unë kam vetëm një pyetje: Pas fillimit të procedurës, siç ka filluar për këtë ligj, ndërhyrja e UNMIK-ut a është tejkalim kompetencash apo jo?

I kisha lutar juristët që ta sqarojnë këtë rast. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Pikërisht juristët më kanë sygjeruar që të heqet nga rendi i ditës. Procedojmë me rendin e ditës, me atë që kemi mundësi të procedojmë. Besoj se ajenden e kemi aprovuar. Prosesverbali në rend të ditës dhe skripti i mbledhjes së kaluar.

Unë do të preferoja gjithmonë me qenë më të efektshëm. Ata që kanë vërejtje në lidhje me këto dokumente, le t'i bëjnë me shkrim në mënyrë që të inkorporohen, por në qoftë se ndokush si deputet ka ndonjë vërejtje, atëherë urdhëroni.

Ju falemnderit. Po procedojmë.

Në rend dite i kemi rekomandimet pér emërimin e gjiqtarëve dhe të prokurorëve. Shpresoj se materialin e keni marrë me kohë. Në Kryesi janë bërë disa plotësime të domosdoshme që kanë munguar pér mbledhjen e Kryesisë e tani shpresoj është kompletuar.

Prandaj, hapi debatin lidhur me këtë çështje. Le ta fillojë diskutimin vetëm kryetari i Komisionit. Urdhëroni, zoti Bajrami.

ARSIM BAJRAMI:

I nderuar kryetar, të nderuar kolegë,

Në pajtim me dispozitat e Kornizës kushtetuese është përcaktuar një mekanizëm i veçantë pér zgjedhjen e gjiqtarëve dhe prokurorëve. Ky mekanizëm në një fazë njeh dhe pranon edhe përgjegjësitë dhe kompetencat e Kuvendit të Kosovës.

Komisioni pér çështje gjiqësore, legislative dhe kushtetuese, si Komision më i afërt pér këtë materie, ka mbajtur një mbledhje të përbashkët me përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial dhe Gjiqësor dhe ka shqyrtuar propozimet që i keni sot para veti veç e veç pér çdo kandidat. Natyrisht, me rastin e rekomandimit që kemi bërë pér Kuvend, ne jemi nisur nga kushtet ligjore pér zgjedhjen e gjiqtarëve dhe prokurorëve. Njëkohësisht, Komisioni ka përcaktuar edhe disa kushte plotësuese pér zgjedhjen e gjiqtarëve dhe prokurorëve. Dispozitat e tanishme ligjore pér zgjedhje në funksionet gjiqësore në Kosovë parashohin kryesisht dy kushte themelore. Kushti i parë është: të kenë mbaruar studimet e drejtësisë dhe, kushti i dytë: – të kenë licencën pér të punuar si gjiqtar apo prokuror, përkatësisht të kenë të dhënë provimin e jurisprudencës si dhe një përvojë pune.

Duke shqyrtuar këto kushte, ne kemi ftuar përfaqësuesit e Këshillit Prokurorial Gjiqësor, të cilët kanë ardhur me të dhënat e plota dhe pér çdo kandidat veç e veç janë analizuar të dhënat. Duke u nisur nga kjo, ne kemi bërë një propozim që ka tre rekomandime pér Kuvendin e Kosovës:

Rekomandimi i parë ka të bëjë me kandidatët që rekomandohen t'i propozohen Përfaqësuesit Special pér zgjedhje;

Në grupin e dytë janë rekomandimet pér kandidatët të cilët nuk propozohen pér zgjedhje pér shkak se Komisioni ka gjetur të dhëna, sidomos në karrierën e tyre profesionale pas viteve të 90-ta, që kanë implikime në sistemin e gjiqësisë në kohën kur është rrënuar sistemi gjyqësor në Kosovë; dhe

Kategoria e tretë e kandidatëve është pér të cilët Komisioni ka rekomanduar që të shtyhet zgjedhja derisa në ndërkohë të mos sigurohen të dhënat plotësuese të cilat Komisioni i konsideron me relevancë me rastin e dhëniec së një rekomandimi.

Dhe, në fund, po shihni se duke shqyrtuar ankesat e kandidatëve që i kanë paraqitur me rastin e zgjedhjes që kemi bërë para disa kohësh, Komisioni ka rekomanduar që vetëm një kandidati t'i aprovohet kërkesa dhe ai rekomandohet të zgjedhet.

Ndërkaq, për kandidatët tjerë nuk ka prova tjera të cilat do të ndikonin në rekomandimin e Kuvendit të Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Muhamet Kelmendi, le të bëhet gati Ramadan Kelmendi.

MUHAMET KELMENDI:

Të nderuar zonja dhe zotërinjë,

Unë kam qenë në punën e Komisionit dhe natyrisht atje kam shprehur mendimin tim për dy çështje shumë të rëndësishme. Çështja e parë ka qenë se a duhet të pranojmë gjyqtarë nëpër gjykata dhe në sistemin juridik të Kosovës njerëz të cilët ende nuk e kanë kryer provimin e jurisprudencës. Shumica nga ata të cilët janë propozuar këtu del se nuk e kanë kryer provimin e jurisprudencës. Ka edhe të tillë që e kanë kryer. Dhe, çështja e dytë, për të cilën unë për veti kam shprehur rezerva jashtëzakonisht të mëdha në Komision, ka qenë çështja që pas ndërrimeve kushtetuese të vitit 89, me fjalë tjera, pas rrënimit të sistemit gjyqësor të Kosovës, ku kanë shërbyer këta njerëz, në cilët mekanizma të shtetit të Serbisë kanë shërbyer dhe këta mekanizma kanë qenë shtypës në Kosovë, këto gjykata të të gjitha niveleve. Fjala është për gjykata për kundërvajtje, gjykata komunale dhe të qarkut në të cilat kanë shërbyer këta njerëz dhe kanë kryer sistem represiv mbi popullin e Kosovës dhe nga këta të propozuar, edhe në Komision kam qenë kundër të këtyre të propozuarve e edhe sot po deklaroj se jam kundër këtyre të propozuarve, sepse 16 të këtyre të propozuarve kanë shërbyer nëpër gjykatat komunale, gjykatat e qarkut dhe në institucionet tjera të shtetit të atëhershëm të Serbisë. Unë kam nxjerrë disa të dhëna që i ka Komisioni të cilat tregojnë se ku kanë punuar këta njerëz. Mund të them me bindje se shumica prej tyre kanë punuar nëpër gjykata e më tutje. Prandaj, u preferoj deputetëve të Kuvendit të Kosovës që si Komisioni që i ka patur këto të dhëna lidhur me këta njerëz që sot rekomandohen të zgjedhen gjyqtarë, t'i kenë edhe deputetët këto të dhëna dhe pastaj të jenë në gjendje me vendosë se a duhet apo nuk duhe me të vërtetëtë të rekomandohen si gjyqtarë. Sepse, vetëm me një listë të tillë, pa të dhënat konkrete të cilat i ka patur Komisioni, në mënyrë që deputetët të jenë në gjendje me vendosë në mënyrë të lirë, mendoj se nuk do të ndërtojmë një sistem juridik të fortë që duhet t'i shërbejë Kosovës.

Në fund, duhet të them një mendim timin kështu konkret. Për mendimin tim, nga të dhënrat të cilat i kam parë këtu, shumica prej tyre duhet t'u dorëzohen organeve të drejtësisë së Kosovës për të konstatuar se në Gjykatën e Qarkut të Prishtinës, ku ka shërbyer personi që sot propozohet me u zgjedh përsëri gjyqtar, apo në gjykatën komunale, çfarë veprimtarie ka kryer ai njeri dhe pastaj, do të thotë, t'i dorëzohen

gjykatës së drejtësisë së Kosovës në mënyrë që drejtësia të merret me këta e jo ne që gjendemi këtu e t'i propozojmë për rekomandim si gjyqtarë në të gjitha nivelet e Kosovës. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. E ka fjalën Ramadan Kelmendi.

RAMADAN KELMENDI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë dhe ministra,
 Vërtetë, unë nuk dola që ta vëj në pyetje punën e Komisionit juridik dhe legjislancë
 dhe propozimin e tyre gjegjësisht rekomandimin. Mirëpo, desha ta shtroj çështjen se
 me të vërtetë në listën e të propozuarve gjenden kandidatë të cilët në mënyrën më
 besnikë kanë rrespektuar dhe zbatuar ligjet diskriminuese mbi shqiptarët dhe se të
 tillët mendoj nuk e meritojnë që ne t'ua dhëmë të drejtën që ta ndajnë drejtësinë.
 Posaçërisht këtu do të isha përqëndruar në Gjykatën Komunale të Mitrovicës dhe te
 katër të propozuarit, dhe jo vetëm se janë të implikuar, por në mënyrën më besnikë e
 kanë rrespektuar. Dhe ne, nëse kështu fillojmë, vërtetë gjyqësinë do t'ua dorëzojmë
 atyre që e kanë keqpërdorur gjatë tërë mandatit të tyre, gjatë tërë kohës së tyre. Nuk
 do të kisha hyrë në atë se a i kanë plotësuar kushtet dhe kriteret, mirëpo do të kisha
 parashtruar edhe unë gjithashu kërkesën që vërtetë ne deputetët ta kemi një biografi
 të shkurtër të oscilimit të punës së këtyre kandidatëve ku kanë punuar prej vitit 81 e
 deri me rastin e propozimit të ri. Pa këto të dhëna, vërtetë për këta kandidatë është
 vështirë... Ne gabime të tilla po bëjmë shpesh. Në shumë institucione kanë arritur
 njerëzit në funksione, u janë besuar funksione në të cilat kanë pranuar masat e
 dhunshme dhe pushtetin e Serbisë dhe ne sot heshtazi i pranojmë ata që të na dajnë
 fatin, ose të na udhëheqin, ose të na neverisin. Dhe, unë vërtetë me shembull konkret
 me plot argumente mund të dal, për shembull për Mehmed Xhekoviqin, ku ka punuar
 e çka ka punuar e i dua të dhënët dhe unë askujt nuk i them pastaj ngriteni dorën apo
 mos e ngritni. Pastaj, Jelena Krivokapiq. Po ajo, 16.850 denoncime për ndërprerjen e
 marrëdhënies së punës punëtorëve shqiptarë, i ka refuzuar me një vendim në
 "Trepçë" dhe e njoh personalisht. Për mua nuk është me rëndësi a e ka dhënë
 provimin e jurisprudencës apo s'e ka dhënë. Me rëndësi është se ka zbatuar vendime
 diskriminuese. Pastaj Liljana Maksimoviq. Për të unë mund të flas orë të tëra, sikur
 që kisha folë edhe për Oliver Ivanoviqin, për të cilin nuk më është dhënë rasti të flas
 dhe sot i dijmë pasojat çfarë janë. Dhe, do të shkoj edhe në Komunën e Zubin
 Potokut, aty ku i njoh dhe ështe fatkeqësi që Jelica Markoviq të gjendet si gjyqtare,
 atje do ta gjykojë vetëm Çabrën. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Urdhëroni zonja deputete.

TEUTA HADRI:

Të nderuar deputetë, i nderuar kryetar,
 Unë kisha për ta pyetur zotin kryetar - kush e ka caktuar atë komision për zgjedhjen
 dhe propozimin e këtyre kandidatëve. Dhe ne, besoj që edhe nga zyra e Shtajnerit
 duhet të pyetemi edhe ne të Kuvendit të Kosovës, e nëse nuk pyeten këta njerëz,
 sepse edhe vetë kam qenë e dënuar politike, dhe të montojnë aso gjyqe fallse e që na
 e kanë humbur edhe jetën, një pjesë të bukur të jetës e sot Kuvendi i Kosovës të mos
 jetë në gjendje të votojë apo t'i propozojë kandidatët sepse edhe në këtë Kuvend dhe
 kudo në Kosovë ka njerëz mjaft të ndershëm dhe që e kanë kryer edhe provimet
 përkatëse që i përgjigjen. Prandaj, ai komision qoftë që bëhet edhe nga zyra
 qendrore, duhet të pyeten nga Kuvendi, nga anëtarët e Kuvendit. Në qoftë se nuk
 pytet, atëherë përse vijmë ne këtu? Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Unë do të doja ta dij përgjigjen që e bëri pyetjen zoja deputete se kush e ka caktuar
 atë komision. Ku ta dij unë, moj zonjë, se kush e ka caktuar! Ne procedojmë si
 Parlament për materialet që arrijnë në Parlament dhe kemi obligim që ta ndjekim
 Kornizën kushtetuese, Rregulloren e punës dhe të gjitha veprimet dhe punët e
 komisioneve që i kemi zgjedhur vetë. Zoti Kurteshi, besoj se s'keni nevojë dy herë
 për të njëjtën çështje, por nëse insistoni atëherë urdhëroni.

ISMAJL KURTESHI:

Nuk do të flas për të njëjtën çështje. E kam prap një pyetje: - A mendoni se deputetët
 janë të përgatitur të votojnë drejtë, nëse në lista kanë vetëm emrat dhe asnë shënim
 tjetër për deputetët dhe a do të duhej t'i kemi edhe shënimet plotësuese, biografitë e
 atyre njerëzve për të cilët po votojmë? Dhe, pyetja ime e dytë, është: Duke i
 rehabilituar njerëzit e një sistemi represiv a po e rehabilitojmë sistemin duke e
 distancuar vetëm kreun e atij sistemi – Millosheviqin? Nëse i rehabilitojmë të gjitha
 mekanizmat e Millosheviqit ne po e rehabilitojmë sistemin e tij. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Të falemnderit. E ka fjalën zoti Bujar Dugolli.

BUJAR DUGOLLI:

Ju falemnderit kryetar,
 Unë mendoj se nuk kemi njohuri të duhura si deputetë për ta bërë këtë rekomandim
 siç e ka kërkuar UNMIK-u. Është thënë, më duket me të 14-tin duhet të aprovojen
 nga Përfaqësuesi special. Unë mendoj se ky Kuvend duhet t'i drejtohet UNMIK-ut
 me një kërkesë, Përfaqësuesit special, se në rast që e don rekomandimin e qartë të

nga Përfaqësuesi special. Unë mendoj se ky Kuvend duhet t'i drejtohet UNMIK-ut me një kërkesë, Përfaqësuesit special, se në rast që e don rekomandimin e qartë të Kuvendit të Kosovës, atëherë duhet të na jep kohë e të vendosim për këta njerëz. Mendoj se ne nuk i kemi as kushtet që të ngrisim dorën për ta, kur nuk dijmë për ta se kush janë dhe çfarë aktiviteti e pune kanë kryer në të kaluarën. Dhe mendoj se ato kritere të cilat i ka paraqitur Komisioni duhet të na i paraqet edhe ne deputetëve me anë të shkruar se në çfarë kritere u nisë e që i ka lejuar këta dhe atyre kriterieve t'u bashkëngjitet edhe biografia e këtyre njerëzve që ne të dijmë më drejt se si do të votojmë.

Ndërsa, në një kaptinë të veçantë, kërkoj edhe nga Komisioni për çështje legjislative kushtetuese të na informoj rrëth Këshillit prokurorial të Kosovës – kush është ky këshill, kush e ka emëruar, kush janë këta njerëz dhe a ka mundësi Kuvendi i Kosovës që ta formojë këtë këshill e mos të formohet ky këshill nga ndokush tjetër dhe të na qet para një akti të kryer e të bijmë në pozita të palakmueshme.

Mendoj që sot vetëm një kërkesë duhet t'ia bëjmë UNMIK-ut që të zgjatet ky afat për aprovimin e këtyre dhe të na lë mundësinë që në rast se e do rekomandimin e Kuvendit atëherë t'ia bëjmë në mënyrë adekuate. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Të falemnderit. Urdhëroni, Sadik Idrizi.

SADIK IDRIZI:

Mislim da preporuke koje je dao Savet sudijski i tužilaca Kosova i Komisija koja je razmatrala, neke stvari mislim trebamo ovde razjasniti. Mi kao poslanici Skupštine ne znam koliko smo u stanju da poznajemo biografije pojedinih ljudi iz drugih opština odnosno iz opština u kojima nismo živeli. Hteo sam samo jednu stvar koja se tiče onog spiska trećeg, ona treća kategorija sudijski koji su predloženi i koji su ostavljeni bez dovoljnih podataka. Pominje se ime jednog kandidata iz opštine Dragaš. Ne želim da govorim o njegovoj biografiji pozitivnu ili negativnu. Mislim da je radio u ovom periodu ali bez nekih komplikacija. Drugo je pitanje što u slučaju da se nastavi ovako, znači odbijanja i produžetak, da se još podataka prikuplja o ljudima, mi u Opštinskom sudu u Dragašu ukupno znači imamo samo jednog pripadnika Bošnjaka odnosno Goranaca zavisi kako se ko izjašnjava i mislim da bi trebalo i krajnje da vreme da se u taj sud pošto je bilo predloženo da se primi čovek iz te zajednice, jer na taj način potrebno je u sudovima, znači tamo gde žive manjinske zajednice, da se popuni broj sudijski. Jer, dešava se, da već tri godine posle rata, u mestima znači gde živi značajan deo zajednica, koja čini 40 procenata i tako dalje, u opštinskim sudovima gde je po desetak sudijski, ne znam tačan broj da ne bih ovde pogrešio i to, da radi samo po jedan pripadnik jedne zajednice... Zbog toga mislim da bi trebalo neke stvari ovde da se ažuriraju. Hvala.

KRYESUESI:

Falemnderit. E ka fjalën Bajram Kosumi.

BAJRAM KOSUMI:

I nderuar kryetar,

Unë kam marrë pjesë në Komisionin kur janë diskutuar këta emra këtu dhe megjithë vullnetin e mirë të Komisionit, ne nuk kemi pasur informacione të mjaftueshme për secilin veç e veç. Për secilin veç e veç është diskutuar dhe votuar. Por unë, tash kur dëgjova të dhëna të reja, mendoj se ne duhet ta ndryshojmë pak jo procedurën por materien e punës sot. Në Kryesi jemi marrë vesh që deputetëve me iu shpërndarë jo vetëm emrat por me iu shpërndarë edhe biografitë e secilit prej këtyre që janë të rekomanuar këtu dhe Sekretaria nuk e ka bërë këtë dhe çështje e saj është pse nuk e ka bërë. Mirëpo, unë mendoj tash se ne nuk mund të kërkojmë prej deputetit që të votojë për gjyqtarin ose për prokurorin që është një prej çështjeve më të ndieshme pa e dijt kush është dhe pa e dijt çka është. Prandaj, unë e dij procedurën, e di se Përfaqësuesi special ka të drejtë sot, më të 14-tin, t'i emërojë vetë pa na pyet neve, por më mirë është që ta bëjë ai vetë, ose të kërkojmë, siç tha edhe zoti Dugolli, që ai ta shtyejë edhe për disa ditë dhe besoj se do të pajtohet edhe Përfaqësuesi special ta shtyjë që së pari t'u shpërndahen biografitë të gjithë deputetëve e ne të marrim të dhëna prej deputetëve ose prej gjykatave komunale dhe komisioni edhe një herë të ulet dhe ta shqyrtojë materien e pastaj të jepë rekandimin. Prandaj, unë jam i mendimit që sot nuk duhet të vendosim për këtë, sepse duhet të votoj ndryshe nga ajo që kam votuar në Komision.

Çështja e dytë që lidhet me këtë, unë po ju them se tash problemi te këta gjyqtar nuk është te Komisioni. Problem është te Këshilli Gjyqësor i Prokurorisë së Kosovës i cili ia çon rekandimet Përfaqësuesit special. Ne kemi një informatë që kësaj radhe për këtë listë kanë kandiduar 90 gjyqtarë dhe ky Këshill i ka rekomanuar Përfaqësuesit special për 40. Neve na ka ardhur rekandimi për 40 veta. Ne kemi rekomanuar, thotë, për 25. Mirëpo, ne nuk kemi qasje për atë këshill, e ai është pikërisht sita e parë që i bjen ose nuk i bjen... Në mesin e këtyre kandidatëve që kanë ardhë, ka pasur kandidatë që vërtetë, sikur që tha zoti Muhamet Kelmendi me shkue drejt në burg. Tërë biografinë e vet, tërë biografinë në jetën e vet e kishte: shefi i UDB-ës, inspektor i lartë, anëtar i shtabit qendror të ushtrisë dhe policisë këtu në Prishtinë dhe ka konkuruar për gjyqtar dhe ky këshill e ka pru te ne. Do të thotë e keqja është te ky këshill. Kush janë në këtë këshill, as unë s'e di. Po mirë, Komisioni e ka refuzuar atë, por problemi është se neve na ka ardhur kandidatura e njeriut që ka qenë anëtar i një shtabi të ushtrisë dhe të policisë në kohën e luftës në Kosovë. Do të thotë problemi është te ky këshill dhe unë po e përfundoj. Komisioni për çështje legislative ta shqyrtojë institucionin e këtij këshilli, kush është ky këshill, kush e emëron këtë këshill dhe kush është në kompetencë të kujt dhe ta diskutojmë ne një ditë në rend të ditës këtu në seancën plenare që këtë këshill ta merrë në mbikëqyrje ky

parlament dhe ne pastaj t'i emërojmë kush janë ata gjyqtarë që e bëjnë atë sitën e parë se përndryshe ne kemi me pasë gjithnjë këso probleme. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. E kam vetëm një ndërhyrje. Shpeshherë më bëhet vërejtje se më shumë po diskutoj se që kam nevojë dhe që kam të drejtë. Unë do ta thoa një çështje: Komisioni e ka kryer punën në mënyrë shumë të ndërgjegjshme; të gjitha informata janë se ka punuar dhe e ka kryer punën e vet brenda kompetencave të veta. Komisioni nuk është kompetent me analizuar kush e ka krijuar atë këshill e ju e dini të gjithë mirë që çështjet e drejtësisë, të judikaturës, të sigurimit janë pjesë e rezervuar e Përfaqësuesit special apo e UNMIK-ut. Unë do t'ju lutja, ne në mënyrë të përshpejtuar po hyjmë në fazat delikate të punës së institucioneve tona dhe vazhdimisht me të drejtë tërë Parlamenti dhe institucionet po kërkojnë bartjen e përgjegjësive në institucionet vendore. Prandaj, kërkimi i fjalës, po e shoh unë, ne pa asnjë nevojë po e akselerojmë procesin, po e ngrisim temperaturën sepse ishin të paraqitur vetëm dy dhe vazhdimisht po shkon duke u shtuar numri i tyre. Ka tendenca në rajon, shumë të theksuara dhe ju të gjithë e dini që për ne edhe shumë më keq flitet për individ dhe kolektivitet dhe nuk do të doja që ne ta vazhdojmë në të njëjtën mënyrë të merremi me historinë, jo ta harrojmë, po të merremi me të kaluarën. Ajo që mund të bëhet dhe mos ta bijmë veten në pozicion të konfrontimit të hapët me kohën është që të shkojmë emër për emër në propozim të Komisionit dhe atje ku ka vërejtje ta lëmë që të kompletohet dokumentacioni plotësues, argumentimi plotësues dhe në ndonjë mbledhje pastaj të funksinojmë. Mos të shkojmë edhe atje ku nuk kemi nevojë me procese të atilla që asnjë ligj të mos nënshkruhet. Atje ku ka arsy, ku kemi argumentim, gjithmonë do ta bëjë punën e vet Parlamenti siç duhet profesionalisht dhe politikisht me përgjegjësi. Prandaj, kush i ka krijuar ato borde para tre vjetës, para dy vjetësh, ne përgjigjemi për kohën prej kur jemi zgjedhur dhe jemi konstituuar si Parlament dhe do të mundohemi t'i përshpejtojmë proceset që ky të jetë një Parlament me të gjitha përgjegjësitë dhe të drejtat.

E ka fjalën zoti Hydajet Hyseni. Le të përgatitet Sabri Hamiti.

HYDAJET HYSENI:

Zoti kryetar, zonja e zotërinjë deputetë,
Megjithë mirëkuptimin për atë që u tha më parë, besoj se të gjithë ne kemi parasysh rrethanat, procesin që po kalojmë e tjera. Megjithatë, çështjen të cilën po e diskutojmë nuk bën ta kalojmë ashtu fëtefët. Është çështje tepër e rëndësishme dhe mendoj se ka plotësish bazë për ta shikuar nga të gjitha aspektet. Së pari unë mbështhes atë që u tha përpara si kërkuesë për të kërkuar prej Këshillit të Gjyqësisë dhe Prokurorisë që ta plotësojë informatën e tyre. Jo për ta komplikuar procedurën, as për ta tensionuar gjendjen por për të vendosur një procedurë të rregullt të vendosjes. Deputetët kanë marrë vetëm listën e kandidatëve të propozuar. Kryesia dhe

Komisioni kanë marrë një material paksa më të zgjeruar por edhe ai është shumë i mangët. Pos kualifikimit dhe përvojës dhe atë të pjesshme, nuk ka të dhëna të tjera. Dhe, ky Kuvend duhet të vendosë në bazë të informacionit të plotë, prandaj ka nevojë të sqarohet së pari: cili është statusi i Këshillit Gjyqësor dhe Prokurorial, cila është përbërja e tij, cilat janë kriteret në bazë të cilave është vendosur kjo përzgjedhje, cilët kanë qenë kandidatët e refuzuar dhe kush është angazhuar në gjithë këtë proces të përzgjedhjes së një efektivi aq të rëndësishëm për të sotmen dhe për të ardhmen e Kosovës. Prandaj, ky Kuvend duhet të kërkojë një informatë gjithpërfshirëse. Ne do të duhej të kërkoni që në procesin e përzgjedhjes të angazhohen edhe institucionet dhe asocacionet tjera kosovare që kanë të bëjnë me këtë fushë. Për shembull, Shoqata e Gjyqtarëve të Kosovës do të ishte krejt normale që të konsultohet dhe të japë mendimin sepse ata do të punojnë bashkë me ta.

Dhe një vërejtje tjeter lidhur me atë që po dëgjohet shpesh se kjo fushë është në kompetencë të rezervuar. Ç’është e vërteta, Korniza jonë është shumë e ngatruar dhe shumë kontradiktore. Lejon edhe mundësinë e interpretimeve të ndryshme dhe krejt kontradiktore. Por, një interpretim, sipas të cilit kjo fushë është krejtësisht e rezervuar mendoj se është i pasakt. Dhe, për ta ilustruar këtë, do t’i referohesha Kornizës kushtetuese, dhe pikës 5.3 e cila shprehimisht thotë: “Institucionet e përkohshme të vetëqeverimit kanë gjithashtu përgjegjësitë e mëposhtme në fushën e çështjeve juridike:

- a) Të marrin vendime sa u përket emerimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- b) Të ushtrojnë përgjegjësinë në lidhje me organizimin dhe funksionimin e rregullt të gjykatave brenda strukturave ekzistuese të gjykatave e të tjera të kësaj natyre”.

Prandaj, mbështetur mbi këtë bazë juridike, pa mohuar dhe pa u konfrontuar me kompetencat e rezervuara të Përfaqësuesit special, por duke siguruar angazhimin përplotësues komplementar të institucioneve të Kosovës dhe të pranisë

ndërkombe, mendoj që ky Kuvend ka të drejtë të kërkojë që kjo çështje të shqyrtohet edhe një herë në ndonjë seancë tjeter dhe t’i kërkohet Këshillit Gjyqësor, dhe Prokurorial që ta kompletojë informatën e tij.

Unë dëshiroj që t’ju informoj se Grupi parlamentar i Partisë Demokratike të Kosovës edhe ka kërkuar në procedurë të rregullt që në seancën e ardhshme të këtij Kuvendi të hapet edhe debati për gjendjen në gjyqësinë e Kosovës. Besoj se një procedim i tillë i duhet Kuvendit të Kosovës dhe çështjes që po e diskutojmë. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Urdhëroni, Sabri Hamiti.

SABRI HAMITI:

Po përpinqem të jam sa më i shkurtër dhe esencial edhe në bazë të asaj që kam para vetes dhe në bazë të fjalëve që dëgjuam këtu. Dihet që probleme ka shumë në këtë fushë dhe u dukën dy nivele. Diskutimi këtu u zhvillua kryesisht në nivelin e Këshillit Prokurorial të Kosovës i cili ka përzgjedhë një nivel të këtyre kandidatëve dhe i ka çuar deri te Komisioni, por kemi edhe nivelin tjetër ku Komisioni që ka përzgjedhur disa, disa i ka refuzuar dhe disa i rekomandon që të përplotësohen biografitë e tyre ose dokumentet, si doni quane. Problemi është edhe pak më fell këtu tash, sepse posa u hap diskutimi ne kishim një diskutim të Ramadan Kelmendit i cili gjenë edhe brenda anëtarëve të rekomanduar nga Komisioni jo vetëm nga Këshilli Prokurorial. Ky është element shumë i ri dhe më i rëndësishëm për hesap timin. Ai bille u bë shumë konkret dhe i përmendi, sa dëgjova unë, pesë emra të dy komunave, ose gjashtë për të cilët thotë është në gjendje të diskutojë me argumente. E pra, tash këtu ne kthehem i në pikën e parë do të thosha të nisjes, dhe unë mendoj që me këtë gjendje që kemi tash të informacioneve, me këtë përzgjedhje që kemi tash qoftë nga ai Këshill qoftë nga rekomandimet e Komisionit ne nuk mund të votojmë për këta njerëz. Dhe unë kujtoj që po sikur unë edhe deputetët tjerë të informuar më shumë ose më pak e kanë si vështirë të ngrisin dorën dhe të japid ndonjë vendim për këtë gjendje që është tash. Shkurt, unë propozoj që krejt kjo punë për sot të ndalet, qoftë edhe si diskutim dhe të mblidhen të gjitha ato dokumente që i ka pasë Kryesia, që i ka pasë Komisioni, e ato plotësuese dhe t'i kemi si dosje në dorë secili dhe pastaj të diskutohet emër për emër në mënyrë që të votohet, përndryshe nuk e shoh logjikë që të votohet.

Dhe për shtesë, po flitet gjithmonë, kur vijnë probleme të rëndësishme – kjo është e drejtë e rezervuar. Nëse është e drejtë e rezervuar, çka po lypë ai që po na i qet përpara këtu, kushdoqoftë ai, Shtajneri ose dreqi i mallkuar. Nëse e ka... Nuk është e vërtetë që e ka të rezervuar, përndryshe nuk do të lodhet me na i pru dokumentet përpara. Dhe, ne do të japid mendim për atë që kemi të drejtë e jo për të rezervuarën e tij, sepse as nuk po na le me u afro dhe as ne nuk do të shkojmë atje. Por të drejtat tonë dojmë t'i realizojmë me ndërgjegje dhe me argumente dhe do t'i votojmë. Për ndryshe jo. Nëse ka të drejtë të rezervuar, ju lutem le të shkruajë dekrete personale, le ta emërojë kë të dojë, por nëse emeron, të lutem shumë, kushdoqoftë, në organe gjyqësore njerëz që i kanë biografitë e kriminalizuara do ta merr edhe përgjegjësinë për emërimin e tyre dhe nuk do ta marrim ne e as ky Kuend. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Unë mendoj se diskutime pati mjaft. Të tri grupet parlamentare në bazë të debatit që u zhvillua janë të mendimit se nuk janë pjekë kushtet që të vendoset sot, do të thotë të shtyhet marrja e vendimit për seancën e ardhshme plenare, ose në një nga seancat e ardhshme. Të ju them vetëm një çështje në aspektin procedural. Dy institucionë brenda Parlamentit kanë vë në rend të ditës që të deklarohen, domethënë Komisioni përkatës që e kemi zgjedhur vetë dhe Kryesia e Parlamentit që e kemi zgjedhur vetë, por elementet e reja, seanca plenare është gjithmonë ajo vendimtarja, ka nevojë për argumentime të mëtejshme prandaj unë mendoj se duhet ta përfundojmë dhe të kërkohen të gjitha informacionet plotësuese në ndërkokë në mënyrë që të vendosim drejt. Urdhëroni, zoti Çelaj.

LIRAK ÇELAJ:

Natyrisht pajtohem, si të gjithë të tjerët, se kjo nuk duhet të votohet, por edhe po i kërkojmë biografitë e gjyqtarëve. Cili është institucioni apo mekanizmi i cili do të na i sjellë neve këto biografit dhe si do të jemi ne të sigurtë se ato biografi janë të sakta, sepse secili mund ta shkruajë një biografi për veti dhe a kemi ne mekanizëm që mund ta verifikojmë që biografia është e saktë, ajo që na vëhet ne përpala, apo jo. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Urdhdëro, e ka fjalën zoti Arsim Bajrami.

ARSIM BAJRAMI:

Unë mendoj se është plotësisht e sakt se Kuvendi ka kompetenca për të diskutuar për këtë çështje, pra nuk është fushë e rezervuar për të cilën Kuendi nuk duhet të diskutojë, pasi që edhe Korniza kushtetuese e ka paraparë bash këtë përgjegjësi. Mendoj se është mëse e domosdoshme që në seancat e ardhshme të hapet debati për gjendjen në sistemin e gjyqësisë për shkak se këtu ka shumë probleme të akumuluarë dhe në qoftë se deridiku kemi legjislativin dhe ekzekutivin që funksionojnë si të pavarura te sistemit të gjyqësisë gjendja është shumë e pavolitshme. Për shkak se vërtetë ne si Komision parlamentar këtu kemi qenë në një pozitë shumë të vështirë për shkak se seleksionimi është bërë diku tjeter dhe seleksionimin e ka bërë një komision prokurorial dhe gjyqësor që ka statusin e komisionit të pavarur. Ai komision nuk është nën ndikimin e Parlamentit dhe komisioni drejtpërdrejt emërohet nga Përfaqësuesi special i Sekretarit të përgjithshëm. Të ju them të drejtën, ai komision është qysh nga përfundimi i luftës i njëjtë dhe është mëse i domosdoshëm që të bëhen ndryshime dhe plotësime. Komisioni prokurorial gjyqësor përbëhet prej 10 anëtarëve, prej tyre 5 janë ndërkombëtarë, 4 janë shqiptarë dhe 1 është serb. Nëse ka nevojë unë mund të ju jap edhe emrat, por mendoj se ky komision duhet të freskohet me njerëz të rinj në mënyrë që t'i kemi propozimet sa më kualitative. Në

rastin konkret, ne kemi ftuar përfaqësuesit e komisionit. Kryesuesi i komisionit ka qenë tërë kohën në mbledhje dhe na i ka prezantuar të dhënat. Aty ku na u janë prezantuar të dhënat e sakta aty kemi marrë qëndrim të mos i rekomandojmë, përkatësisht kemi pasur disa raste që t'i refuzojmë edhe kandidatët e përkatësisë shqiptare por edhe të përkatësisë serbe. Është mëse e nevojshme që propozimet që vijnë këtu të jenë me të dhëna të plota, për arsy se unë i pranoj sot vërejtjet që i patën disa deputetë për kandidatët. Është fjala që ne si Komision parlamentar nuk po i njohim njerëzit. Ne mendojmë se seleksionimi duhet të bëhet te komisioni prokurorial i cili i ka thirrur në intervista. Me çdo kandidat është zhvilluar intervistë dhe aty ka mund të merren të dhënat për aktivitetin e tyre pas vitit 1990. Kështu që për momentin unë mendoj se është konkludim i mirë që për momentin këtë çështje ta shtyjmë dhe ndoshta edhe në kuadër të debatit që të kemi për sistemin e gjyqësisë të marrim qëndrime që vërtetë Kuvendi i Kosovës të jetë i involvuar në sistemin e gjyqësisë në Kosovë.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. E ka fjalën zoti Kuqi.

HAJREDIN KUQI:

I nderuari kryetar, të nderuar deputetë,
 Unë i bashkëngjitem me shty këtë rend të ditës, por mendoj se një herë na ka rrëshqitur kjo pikë e rendit të ditës. Ne kemi votuar një herë për disa kandidatë për gjyqtarë dhe prokurorë, nuk e kemi ditur se për kë, unë personalisht për shumicën e besaoj se edhe ju. Problemi nuk është me shtyrë. Problemi është si mos me ardhë në mbledhjen tjetër në të njëjtën gjendje. Dhe këtu duhet ta bëjmë një zgjidhjen. Ne mund të vijmë pas një jave prap në të njëjtën gjendje. Unë personalisht nuk kërkoj me dijt biografinë e tyre. Por çka kërkoj? Kërkoj që propozimi për ta duhet të vijë nga organet e besueshme. Dhe, si duket edhe komisioni nuk ka patur çka me zgjedh ose çka me marrë. Këtu është problemi esencial. Ne duhet ta rregullojmë mekanizmin përmes Kryesisë së Kuvendit, Komisionit për çështje juridike, legjislacion dhe Kornizë kushtetuese që propozimi i tyre të jetë mbi bazën profesionale por edhe mbi bazë që kërkon një gjyqtar. Mos të bëhem i merak në disa njerëz që themi nuk ka e tjera. Në Kosovë kanë diplomuar mbi 8 mijë juristë. Prej 8 mijëve mund të zgjedhim, ka jashtëzakonisht të mirë dhe nuk e kemi përzgjedhjen aq të ngushtë por edhe më pak kohën. Ne mund të diskutojmë si çështje të me ia marrë të drejtën për punë, por dikujt me ia marrë të drejtën e mos me qenë gjyqtar mund të shpëtojë sistemi juridik në Kosovë. Andaj mendoj se duhet të mendojë Kryesia e Kuvendit jo ta shtyjë këtë

KRYESUESI:

Të falemnderit. Unë mendoj as që kishte arsyet e vazhdohen këto dy-tre diskutime të fundit. Unë thash tri grupet parlamentare në Parlament u deklaruan që të shtyhet marrja e vendimit. Prandaj, mund dikush vetëm nëse është kundër të paraqitet për diskutim dhe të pajtohem i pranishëm.

Po procedojmë më tutje jme rendin e ditës.

Janë edhe pyetjet për ministrin Çeku dhe për ministrin Isufi, të cilat i patën parashtruar Lirak Çelaj për ministrin Çeku dhe Tomë Hajdaraj për ministrin Isufi.

ETHEM CEKU:

Në pyetjen e shtruar nga deputeti i nderuar lidhur me materialet radioaktive që kanë të bëjnë me kompleksin e Trepçës, ne si Ministri e kemi dërguar informacionin me shkrim dhe unë besoj se të gjithë deputetët e kanë marrë. Është një aktivitet i cili është kryer në bashkëpunim në mes Ministrisë, TMK dhe KFOR-it. Nga të gjitha të dhënat që ne i posedojmë si Ministri dhe nga grumbullimet që janë bërë edhe më herët del se aty materialet që janë të vendosura janë të izoluara mirë, janë materiale të cilat nga të gjitha analizat që janë bërë nuk kanë ndikim tanë për tanë në ambient dhe në shëndetin e qytetarëve. Problemi qëndron tanë në faktin se si t'i trajtojmë më tutje ato mbeturina të rrezikshme apo materiale radioaktive. Domethënë, si Ministri tanë i qasemi problemit se si t'i trajtojmë ato më tutje. Janë disa propozime që ato materiale të nxjerren nga vendi, të dërgohen jashtë në përpunime më tutje, prandaj si Qeveri jemi duke u munduar në bashkëpunim me disa institucione tjera shkencore që t'i trajtojmë këto probleme. Por ne duhet të dijmë se këto janë probleme tepër të mëdha të cilat kërkojnë buxhet dhe financa, prandaj ne kemi mbetur këtu me tërë aktivitetin të cilin duhet ta kryejmë. Po ashtu duhet të informoj Parlamentin se ne kemi ndërtuar një bord për menaxhimin e materialeve të rrezikshme e që nuk i takon vetëm ministrisë tonë por është një bord i cili është krijuar nga disa ministri tjera dhe bashkërisht jemi duke iu qasur këtij problemi. Tani kemi një veprim të përbashkët me KFOR-in, me TMK-ën dhe me ministritë tjera. Kjo është përgjegjja dhe jam i gatshëm nëse ka ndonjë pyetje tjetër t'i përgjigjem. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Zoti ministër ju falemnderit. Pjetja e dytë është për Tomë Hajdarajn për ministrin Ahmet Isufi. Zoti Isufi e keni fjalën.

AHMET ISUFI:

I nderuar zoti kryetar, të nderuar deputetë,

ushqimit në Kosovë nuk e ka udhëhequr institucionet e UNMIK-ut përpos në fazën e menjëhershme pas luftës ku Departamenti i Mirëgenies Sociale e ka implementuar një program finansiar emergjent të asistencës sociale. Programi i emergjencës është udhëhequr kryesisht nën ombrellën e Programit botëror të ushqimit në bashkëpunim me shoqatat tjera humanitare të vendit dhe ndërkombëtare.

Ministria e Punës dhe e Mirëgenies Sociale si institucion nuk merret me menaxhimin e fazave emergjente në ushqim, por me hartimin e politikave sociale në formë institucionale që kanë karakter afatmesëm dhe afatgjatë. Është çështje tjetër vlerësimi apo rivlerësimi se a është kaluar koha emergjente, domethënë faza emergjente në Kosovë apo jo. Unë personalisht në një takim që kam pasur me përfaqësuesit e Shoqatës bëmirëse humanitare Nëna Terezë e kam marrë një projekt të hartuar prej tyre për t'i ndihmuar kësaj kategorie të mbi 50 mijë qytetarëve për të cilën ka shfaqur interesim edhe deputeti Tomë Hajdari. E kemi analizuar me kujdes këtë projekt por nuk kemi mund të gjejmë mënyra për t'i ndihmuar kësaj shoqate për ta realizuar këtë projekt, sepse buxheti i Ministrisë së Punës dhe Mirëgenies Sociale është shumë i kufizuar. Numri i atyre që marrin ndihma sociale, duke i përfshirë dy kategoritë, është 51.500 familje. Kur ia shtojmë kësaj shifre edhe numrin prej 3.700 familjeve të invalidëve të luftës, invalidëve civilë të luftës, atëherë numri i përgjithshëm i familjeve që marrin ndihmë sociale është 55.200 familje.

Ne si Ministri, në kushtet dhe rrethanat e tanishme, ka mundësi që t'i ndihmojmë shtresat sociale vetëm në këtë formë, duke u bazuar në ligje dhe kritere të caktuara.

Duhet të theksoj se në kohën e fundit kemi vërejtje nga ndërkombëtarët se ne veç si Ministri kemi shpenzuar tepër në fushën e asistencës sociale. Pra, në këto kushte, Ministria e Punës dhe Mirëgenies Sociale nuk ka mundësi tjera që ta zgjerojë ndihmën dhe përkujdesjen ndaj shtresave të varfëra të shoqërisë. Në vitin e ardhshëm do të përpinqemi që të gjejmë donacione të ndryshme për t'i ndihmuar kësaj shtrese por jo duke u orientuar në ndihma emergjente por në faza pak më të gjata.

Me këtë rast dua të theksoj se Ligji mbi asistencën sociale veç ka kaluar në Qeveri, do të jetë së shpejti para jush dhe të gjithë ata që plotësojnë kriteret në bazë të këtij ligji do të gëzojnë të drejtën e asistencës sociale. Ju falemnderit.

KRYESUESI:

Ju falemnderit. Unë mendoj se është filluar mirë. Pyetjet që i kanë deputetët duhet ta ndjekin procedurën e caktuar. Ju falemnderit për pjesëmarrje aktive. Shihemi në seancën e ardhshme.

Seanca përfundoi punën në orën 11,15.

RT